



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2020:016580
Datë: 18.03.2024
Numri i dokumentit: 05465909
C.nr.44/2020

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-Dega në Kaçanik, si gjykatë civile e shkallës së parë, gjyqtari Riza Livoreka, si gjyqtar individual, me sekretaren juridike Azemine Berisha, në lëndën kontestimore të Paditësit Sh. (R.), K. ,nga Kaçaniku, kundër të paditurës K. e K., të cilën me autorizim e përfaqëson I. L. për çështjen kontestuese kompensim i dëmit, në seancën gjyqësore të mbajtur me datën 04,03,2024, në mungesën e paditësit dhe në praninë e të paditurit, ndërsa me datën 18.03.2024, bëri përpilimin me shkrim të këtij:

A K T V E N D I M

I. Padia e paditësit Sh. (R.), K., nga Kaçaniku, e ushtruar më datën 15.10.2019, kundër të paditurës, K. e K., për çështjen kontestua kompensim i dëmit, konsiderohet e TËRHEQUR.

II DETYROHET pala paditëse që kësaj gjykate të ja paguaj shumën prej 20,00€, në emër të taksës për padi, e cila pagës do të bëhet në afat prej 3 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Paditësit me datën 15.10.2019, në Gjykatën Themelore në Ferizaj Dega në Kaçanik, ka ushtruar padi kundër të paditurës K. e K., për çështjen kontestuese kompensim i dëmit. Pala paditëse ka sqaruar se e paditura me rastin e zgjerimit të rrugës në fshatin ..., në njësinë kaastrale ..., në vendin e quajtur "...", me kulturë bujqësore –kullosë e klasës 3, në sipërfaqe prej 2343m², i ka shkaktuar dëm palës paditëse , duke ja përvetësuar një pjesë të pronës në

mënyrë të kundërligjshme. Po ashtu me këtë padi e ka kërkuar edhe kamatën sipas mjeteve të deponuara në bankat afariste, mbi një vit pa destinacion të caktuar, duke filluar nga data 15.10.2019 (dita e ngritje së padisë), e deri në pagesën përfundimtare si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore.

Gjykata për datën 04.03.2024, e ka caktuar seancën përgatitore, e ka ftuar palën paditëse, e cila edhe pse e ftuar me rregull nuk ka prezantuar në seancën përgatitore, mungesën nuk e ka arsyetuar dhe nuk ka kërkuar shtyrjen e seancës kryesore. Ndërsa i autorizuari i paditësit, ka prezantuar në seancën përgatitore, dhe i ka propozuar gjykatës që padinë e paditësit ta konsideroj si të tërhequr, pasi që i njëjti ka qen i ftuar me rregull mungesën nuk e ka arsyetuar dhe nuk ka kërkuar shtyrjen e kësaj seance. Po ashtu e ka njoftuar gjykatën se pala e paditur e ka përmbushur detyrimin dhe gjykatë ja ka dorëzuar pagesat të cilat ju kanë bërë, në emër të kompensimit.

Gjykata padinë e paditësit, e konsideroj të tërhequr, sepse pala paditëse, është ftuar në mënyrën e paraparë ligjore, e njëjta nuk ka prezantuar në seancën përgatitore, mungesën nuk e ka arsyetuar, nuk ka kërkuar shtyrjen e seancës. Prandaj gjykata veprimi konform nenit 409.2 të LPK-së, me të cilën dispozitë është e paraparë në qoftë se në seancën përgatitore, nuk vjen pala paditëse edhe pse është ftuar rregullisht konsiderohet se e ka tërhequr padinë.

Me dispozitën e cekur më lartë, është paraparë pasoja e mungesës së palës në seancën kryesore. Kështu mungesa e paditësit në seancën kryesore e tërheq në vetë presumcionin e tërheqjes së padisë. Prandaj për tu konsideruar si e tërhequr padia duhet të plotësohen kushtet edhe atë: mungesa e paditësit në seancë, ftesa të jetë bërë me rregull dhe mungesa të mos jetë arsyetuar. Se pala paditëse është ftuar me rregull, këtë fakt gjykata e ka vërtetuar nga flet dërgesa për dorëzim personal e datës 30.01.2024, nga e cila vërtetohet se pala paditëse është ftuar me rregull dhe mungesën nuk ka arsyetuar.

Përcaktimi i ligdhënësit për një zgjedhje të tillë duhet kërkuar në faktin se procedura kontestimore iniciohet, me vullnetin ekskluziv të palës paditëse, prandaj vazhdimi i procedurës pa pjesëmarrjen e paditësit në procedurë nuk do të kishte kurrfarë kuptimi.

Përveç kësaj është në interesin e paditësit që procedura të përfundoj në afat sa më të shkurtë, prandaj sjellja pasive e paditësit në raport me kontestin është tregues, se paditësi e ka humbur interesin për vazhdimin e më tejme të kontestit .

Prandaj gjykata duke marrë parasysh të cekurat më lartë ka zbatuar dispozitën e nenit 409.2 të LPK-së, duke e konsideruar të tërhequr padinë e paditësit , sepse paditësi ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt, mungesën nuk e ka arsyetuar dhe nuk kanë kërkuar shtyrjen e seancës kryesore. Po ashtu pala paditëse i ka propozuar gjykatës që padia e paditësit të konsiderohet e tërhequr, , për shkak të mos pjesëmarrjes në seancë dhe pagesës së bërë.

Gjykata e detyroi palën paditëse, që kësaj gjykate të ja pagua shumën prej 20,00€, në emër të taksës për padi, sepse pala paditëse, nuk e ka paguar taksën me rastin e dorëzimit të padisë në gjykatë, ashtu siqë është paraparë me neni 423,4 të LPK-së dhe Udhëzimin Administrativ për unifikimin e taksave gjyqësore.

Nga se u theksua më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ,

Dega në Kaçanik

C.nr.44/2020 prej datës 04.03.2024

Gjyqtari

Riza LIVOREKA

KËSHILLA JURIDIKE :

Kundër këtij Aktvendimi, pala e pakënaqur mund të ushtroj ankesë në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit, ankesa i paraqitet Gjykatës së Apelit të Kosovës me seli në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme.